

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Mercedes-Benz Group China Ltd., me seli të regjistruar në Apartamentin 2301, Kati 20, Kulla 3, Rruga Wangjing nr. 8, Distrikti Chaoyang, Pekin, Kinë, BMW Brilliance Automotive Ltd., me seli të regjistruar në nr. 1, Bulevardi Baoma, Zona e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjik Shenyang, Shenyang, Provinca Liaoning, Kinë, dhe Seres Group Co., Ltd., me seli të regjistruar në nr. 7, Rruga Wuyunhu, Distrikti Shapingba, Chongqing, Kinë, përmes avokatit Filip Zafirovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 17.08.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Mercedes-Benz Group China Ltd., me seli të regjistruar në Apartamentin 2301, Kati 20, Kulla 3, Rruga Wangjing nr. 8, Distrikti Chaoyang, Pekin, Kinë, BMW Brilliance Automotive Ltd., me seli të regjistruar në nr. 1, Bulevardi Baoma, Zona e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjik Shenyang, Shenyang, Provinca Liaoning, Kinë, dhe Seres Group Co., Ltd., me seli të regjistruar në nr. 7, Rruga Wuyunhu, Distrikti Shapingba, Chongqing, Kinë, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Beijing IONCHI New Energy Technology Co., Ltd., me seli të regjistruar në Katet 1 deri 10, Dhoma 101, Kati 8, Ndërtesa nr. 2, Rruga Lu Zi Zhuang nr. 36, Distrikti Chaoyang, Pekin, Kinë, përmes marrëveshjes për rritjen dhe nënshkrimin e kapitalit, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19, paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 17.07.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar njoftimi për përqendrim nga Mercedes-Benz Group China Ltd., me seli të regjistruar në Apartamentin 2301, Kati 20, Kulla 3, Rruga Wangjing nr. 8, Distrikti Chaoyang, Pekin, Kinë, BMW Brilliance Automotive Ltd., me seli të

regjistruar në nr. 1, Bulevardi Baoma, Zona e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjik Shenyang, Shenyang, Provinca Liaoning, Kinë, dhe Seres Group Co., Ltd., me seli të regjistruar në nr. 7, Rruga Wuyunhu, Distrikti Shapingba, Chongqing, Kinë, me të cilin Mercedes-Benz Group China Ltd., BMW Brilliance Automotive Ltd. dhe Seres Group Co., Ltd. do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Beijing IONCHI New Energy Technology Co., Ltd., me seli të regjistruar në Katet 1 deri 10, Dhoma 101, Kati 8, Ndërtesa nr. 2, Rruga Lu Zi Zhuang nr. 36, Distrikti Chaoyang, Pekin, Kinë.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimet të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Veprimtaritë kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Mercedes-Benz Group China Ltd. është shoqëri e varur e Mercedes-Benz Group AG (së bashku me shoqëritë e saj të varura emërtohen si „**Mercedes-Benz Group**“). **Mercedes-Benz Group** është një grup global automobilistik i cili zhvillon, prodhon dhe plasun në treg automjete për udhëtarë, duke përfshirë edhe automjetet nën markat Mercedes-Benz, Mercedes-AMG dhe Mercedes-Maybach. Aktivitete të tjera të Mercedes-Benz Group përfshijnë prodhimin dhe marketingun e furgonave si dhe ofrimin e shërbimeve financiare, siç janë financimi, lizingu, sigurimi, menaxhimi i flotës së automjeteve dhe veprimtaria bankare, si dhe shërbimet e mobilitetit.

Mercedes-Benz Group nuk ka shoqëri të varura, degë apo përfaqësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Mercedes-Benz Group vepron në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes një distributori të pavarur.

BMW Brilliance Automotive Ltd. kontrollohet ekskluzivisht nga Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft (shoqëri aksionare, së bashku me shoqëritë e saj të varura emërtohen si „**BMW Group**“). **BMW Group** është një nga prodhuesit më të suksesshëm të automobilave për udhëtarë dhe motoçikletave në botë, me seli në Munih, Gjermani. Markat kryesore tregtare të **BMW Group** përfshijnë BMW, MINI, Rolls-Royce dhe BMW Motorrad. Automjetet për udhëtarë përfshijnë automjete hibride plug-in dhe automjete elektrike.

BMW Group nuk ka shoqëri të varura, degë apo përfaqësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut. BMW Group vepron në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes një distributori të pavarur.

Seres Group Co., Ltd. – së bashku me personat e saj të lidhur emërtohen si „**Seres Group**“. Seres Group Co., Ltd. është një kompani automobilistike e orientuar drejt teknologjisë, me veprimtari bazë automjetet me energji të re, dhe aktualisht është e kuotuar si në tregjet e aksioneve të klasës A, ashtu edhe në tregjet e aksioneve të klasës H. Veprimtaria afariste e Seres Group përfshin kërkimin dhe zhvillimin, prodhimin, shitjen dhe shërbimet e automjeteve me energji të re dhe të komponentëve bazë për automjete me energji të re.

Seres Group Co., Ltd. nuk ka shoqëri të varura, degë apo përfaqësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2025, Seres Group Co., Ltd. kryesisht merrej me eksportin e automjeteve të kompletuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut (drejtpërdrejt te distributorët lokalë).

Beijing IONCHI New Energy Technology Co., Ltd. është themeluar si një sipërmarrje e përbashkët ndërmjet Mercedes-Benz Group China Ltd. dhe BMW Brilliance Automotive Ltd. në mars të vitit 2024. Beijing IONCHI New Energy Technology Co., Ltd. menaxhon infrastrukturën publike të mbushjes (karkimit) me fuqi të lartë dhe rrjetin e shërbimeve të mbushjes për automjete me energji të re në Kinë. Me seli në Pekin, Beijing IONCHI New Energy Technology Co., Ltd. ofron 100% mbushje me energji elektrike të rinovueshme për automjete me energji të re.

Beijing IONCHI New Energy Technology Co., Ltd. nuk ka prani dhe nuk ka veprimtari afariste në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ